

**Pyetjet dhe përgjigjet nga Takimi Orientues (webinar), i zhvilluar më 05 Maj, ora 10:00, si pjesë e thirrjes së dytë për projekt propozime nga projekti ideAL**

**1. A është e mundur që anëtarët e ndryshëm të rrjetit /organizatat të aplikojnë për një propozim tjetër?**

Jo nuk është e mundur, një person që është aplikues nuk mund të jetë edhe ekspert në një projekt propozim tjetër. Në një rast të tillë të dyja aplikimet do të s'kualifikohen.

**2. A ka ndonjë tavan për pagat dhe shpenzimet e tjera lidhur me burimet njerëzore?**

Jo, nuk ka një tavan të përcaktuar. Hartimi i buxhetit duhet të ketë një rrjedhje logjike me aktivitet që prezantohen në kuadër të projekt propozimit dhe të buxhetojë/parashikojë aktivitete të cilat janë në linjë dhe koherencë të plotë me objektivin e thirrjes.

**3. A do të njihet tatimi në burim për ekspertët?**

Po do të njihet, ajo është një kosto e njohur për aq kohë sa e paguani atë. Për të paguar tatimin në burim për ekspertët duhet të keni dokumentet justifikues si kontrata e shërbimit, pagesa dhe raporti që ka prodhuar, krahas produkteve që faktojnë shërbimin (*deliverables*).

**4. Sa përqind e buxhetit duhet të ndahet për burimet njerëzore apo shërbimet e tjera?**

Nuk ka një kufizim, por për sa kohë ju kërkohet që të keni aktivitete që kërkojnë të përbushin disa kritere, rrjedhimisht i gjithë buxheti nuk mund të alokohet për staf. Hartimi i buxhetit duhet t'i qëndrojë linjës së projektit, në rast se ka aktivitete brenda organizatës pjesa më e madhe e buxhetit mund të jetë për burimet njerëzore ndërsa nëse keni aktivitete të jashtme, të cilat dalin përtej organizatës atëherë buxheti duhet të shkojë për këto aktivitete të cilat kanë në fokus ndikimin në politikbërje.

**5. A ka një përqindje për kostot e administrimit të grantit?**

Jo. Nuk ka kosto për administrimin. Buxheti duhet të jetë i hartuar vetëm përmes kostove direkte. Gjithashtu, nuk ka një përqindje të përcaktuar sepse kjo varet nga aktivitet e planifikuara. Aktivitetet të cilat planifikoni përcaktojnë buxhetin tuaj dhe peshën që mund të ketë secila kategori.

**6. Nëse aplikojmë si organizatë me mbështetjen e rrjetit, si do të mbështesim financiarisht organizatat e rrjetit? A duhet të paguajmë me kontratë individuale apo me marrëveshje bashkëpunimi mes organizatave?**

Sipas pikës 2.1.2, "Çfarë aktivitesh mbështeten financiarisht?", mbështetja financiare nuk është një aktivitet i lejueshëm për thirrjen në rast se ju do të keni një ekspert/personat të tjerë të përfshirë në grupin tuaj të punës duhet të lidhen marrëveshje individuale. Ju mund merrni mandatin ose të aplikoni me organizata të tjera. Si pjesë e kësaj thirrje ne inkurajojmë bashkë-aplikimet/ aplikimet në partneritet, por siç shpjegohet në pikën 2.1.1: "bashkë-aplikantët potencialë duhet të plotësojnë të njëjtat kritere sikurse dhe vetë aplikanti".

**7. A kanë të drejtë aplikimi universitetet?**

Universitetet si institucione publike nuk janë të rregjistruar sipas legjislacionit shqiptar për organizatat jofitimprurëse prandaj nuk mund të aplikojnë, por ka dy alternativa të tjera të aplikimit për universitetet:

- 1) Si person natyror (individ) me një letër mbështetëse nga Universiteti/ Fakulteti/ Departamenti;
- 2) Nëse universiteti ka një strukturë jo fitimprurëse e regjistruar si e tillë pranë / pjesë e universitetit, si p.sh. një institut kërkimor, mund të aplikoni përmes tyre.

**8. A mundet që grupi i hulmuesve të jetë stafi i atij universiteti dhe të këtë letër mbështetëse nga vetë institucioni?**

Po, ju mund të aplikoni si individë me letër mbështetëse nga Universiteti/ Fakulteti/ Departamenti, sipas alternativës së parë të cekur më lartë.

**9. A kanë të drejtë aplikimi studiot/ dhomat e tregtisë/ bashkitë ?**

Bazuar në kriteret e lejueshmërisë, detajuar në seksionin 2.1.1 “Kush mund të aplikojë”, një aplikant duhet të përmbushë disa kriteret, përfshirë pikën 2: **“Të jetë një organizatë e shoqërisë civile, e regjistruar si jo-fitimprurëse, sipas legjislacionit shqiptar për organizatat jofitimprurëse”**. Në këtë thirrje mund të aplikojnë të gjitha organizatat e shoqërisë civile jofitimprurëse, të njohura sipas legjislacionit në fuqi.

**10. Nëse një individ ka aplikuar më parë dhe është s’kualifikuar, a mund të ofertojë më vonë një organizatë për ekspert pa qenë i përfshirë në stafin e projektit?**

Jo. Nuk është e mundur. Aplikimi do të vlerësohet dhe për cilësinë e stafit/eskperëve që përfshijnë që në fazën e propozimit.

**11. Çfarë nënkuptoni me dialog?**

Dialogu nënkupton të gjitha aktivitetet advokuese ku keni komunikim me aktorët e përfshirë në politikën që ju doni të ndikoni. Pjesë e procesit të dialogut mund të jenë zhvillimi i takimeve me aktorët, takimet e hapura, takimet në Këshillin Bashkiak, pra të gjitha aktivitetet të cilat kanë si qëllim ndikimin për çështjen dhe politikën që adresoni.

**12. Nëse projekt propozimi ka të bëjë me politikat lokale, a mund të operohet në nivel bashkie apo qarku?**

Po mund të operohet, por projekt propozimi nuk duhet të jetë për një çështje që ka të bëjë me përmirësimin e një shërbimi apo të kapaciteteve, por të jetë e fokusuar tek një politikë e caktuar lokale. Çështja e ngritur duhet të ketë edhe rëndësi për bashkitë e tjera. Nga pikëpamja e politikbërjes në nivel lokal mund të mos jenë të gjitha bashkitë në Shqipëri, por mund të jenë vetëm disa bashki të zonave të ndryshme apo një qarku.